

Sadik Zenku, MA
Mendim Zenku, MA

UDC:
321.7:316.323.65

**SHTETI JURIDIK NË FUNKSION TË DEMOKRATIZIMIT TË
SHOQËRISË**

**ПРАВНАТА ДРЖАВА ВО ФУНКЦИЈА НА
ДЕМОКРАТИЗАЦИЈА НА ОПШТЕСТВОТО**

**LEGAL STATE IN THE FUNCTION OF DEMOCRATIZATION OF
SOCIETY**

Abstract

The work in question intends to point out that the meaning and importance of social and legal state, to theoretically scientific terms, arises as a necessity from the relevance of its social political life in all democratic states, especially as an issue for post-communist countries that still are in the transition process. It is well known that the functioning of the legal state with all its attributes, is a key component in the consolidation of the modern democratic state, which should be guided by the principle of rule of law that applies to everyone equally.

At the same time, this work attempts to address the key elements of contemporary democratic states, which are interdependent and very important for a functional state that is dedicated to the realization of a society in which the human rights and freedoms will be the first plan on their agenda, both in terms of natural law and in terms of legal positivism as well.

This work aims to promote the importance of the democratic rule of law in its contemporary context as a legal and sociological category, which provides the optimal framework for human freedom, their equality in chances of success, the equality in front of the state authorities

and the law, but also the state limitation in prevention and in inability of abuse and arbitrariness. Rule of law, must depart and rely on basic human principles of all social values such as law, justice, morality and principles of democracy.

The intention of the work lies precisely in proving that without functioning of the legal state we can not be able to build the modern state that is based on a consolidated democracy.

Key words; rule of law, democracy, human rights, constitutionality, non-discrimination.

SHTETI JURIDIK NË FUNKSION TË DEMOKRATIZIMIT TË SHOQËRISË, KUPTIMI DHE RËNDËSIA

Në literaturën shkencore shqiptare hasen dhe përdoren së paku dy terma për të shpjeguar kuptimin e shtetit të së drejtës. Fillimisht duhet të sqarojmë se cila është terminologjia që duhet të pranojmë: shteti juridik (ligjor) apo shteti i së drejtës, terma këto të përdorura gjerësisht sot në literaturën politike, sociologjike e juridike. Të dyja termat kanë të njëjtin kuptim, shprehin të njëjtin koncept, atë të lidhjes së ngushtë dhe reciproke midis shtetit dhe së drejtës.

Përkufizimi i Shtetit të së drejtës ndryshon sipas autorëve dhe epokave. Shteti i së drejtës është para së gjithash një model teorik në kuadër të organizimit të sistemeve politike. Ai është bërë një temë themelore e politikës meqenëse konsiderohet si një nga karakteristikat kryesore të regjimit demokratik. Përgjithësisht një Shtet i së drejtës nuk është detyrimisht demokratik, por çdo Shtet demokratik është një Shtet i së drejtës. Shteti i së drejtës, kështu paraqet një etapë të parë në formimin e një Shteti demokratik. E kundërta e tij është *despotizmi* ose *regjimi policor*, ku mbretëron arbitrariteti dhe regjimi i dhunës.

Në sensin më të thjeshtë, sundimi i ligjit është një sistem që tenton të mbrojtë të drejtat e qytetarit nga përdorimi arbitrar dhe abuziv i pushtetit të qeverisë. Kështu, në traditën ligjore perëndimore sundimi i ligjit është shikuar si një mburojë kundër despotizmit dhe si zbatim i kufizimeve ndaj forcës së qeverisë. Kohët e fundit sundimi i ligjit është konsideruar si një prej dimensioneve kyçe që përcakton cilësinë dhe mirëqeverisjen e një shteti.

Sipas një përkufizimi të vjetër shteti i së drejtës është një sistem institucional në të cilin fuqia publike i nënshtrohet të drejtës. Ai bazohet

në parimin thelbësor të respektimit të ligjit, secili në mënyrë të njëjtë i nënshtrohet të drejtës, qoftë ky individ apo pushtet publik. (Fuler, L. 1969: 49)

Juristi austriak Hans Kelsen e ka ripërkufizuar këtë koncept me origjinë gjermane (Rechtsstaat) në fillim të shekullit të XX, si një “Shtet në të cilin normat juridike janë të vendosura sipas hierarkisë në mënyrë që fuqia e tij të jetë e kufizuar”. Në këtë model, çdo normë merr vlefshmërinë e saj në përputhje me normat e mësipërme.

Shteti i së Drejtës mund të përmblihet sipas formulës: “Asnjë nuk është mbi ligjin”. Përgjithësisht, ky regjim grupon një tërësi normash juridike që mbrojnë qytetarët nga format arbitrare të pushtetit (ekzekutiv). Që një Shtet i së drejtës të ekzistojë duhet që detyrimet që lindin prej Shtetit të jenë zyrtare, detyruese dhe me sanksione. Me fjalë të tjera, ligjet duhet të:

- 1) jenë bërë publike,
- 2) asnjë nuk mund t’u shpëtoj atyre,
- 3) ato duhet të zbatohen realisht, dhe
- 4) shkelja e ligjeve duhet të sjell sanksione.

Shteti i së drejtës është shumë i lidhur me respektimin e hierarkisë së normave, ndarjen e pushteteve, barazinë e subjekteve të së drejtës para normave juridike, ekzistencën e pavarësisë së pushteteve dhe garantimin e të drejtave civile dhe politike të individëve. Këto përbëjnë kushtet themelore që duhet të plotësojë një Shtet i së drejtës.

Rëndësia shoqërore e shtetit të së drejtës për nga aspekti teorik shkencor del si domosdoshmëri që lind nga aktualiteti i saj në jetën politike shoqërore në të gjitha shoqëritë të cilat pretendojnë të ndërtojnë shtet demokratik dhe funksional, dhe veçanërisht kjo vlen për shtetet postkomuniste që ndodhen në tranzicion.

Kur flitet për shtetin ligjor flitet për një sistem shtetëror ku sundimi i ligjit është një aksiomë. Ndërsa diskutimet mbi shtetin ligjor bëhen nga pikënisje e aspekte të ndryshme, theksi mbetet në forcimin e shtetit ligjor si një kusht parësor për progres shoqëror si dhe për integrimin në strukturat euro-atlantike. Gjithsesi, sundimi i ligjit, shteti ligjor, apo ‘Rechtstaat’ konsiderohet si një parakusht për demokracinë dhe ka shërbyer si një platformë e përgjithshme për diskutimin rreth respektimit të të drejtave të njeriut.

Një çështje me rëndësi që duhet potencuar është ballafaqimi i shtetit të së drejtës me sfidat e shumta në shoqëritë në tranzicion, gjatë

rrugëtimit të ndërtimit të një shteti demokratik. Një vëmendje e posaçme duhet ti kushtohet të gjitha dukurive shoqërore destruktive që rrënojnë parimet themelore të vlerave të demokracisë. Kështu, sipas disa kërkime dhe hulumtimeve të bëra nga Instituti botëror për qeverisje të mirë, sfidat, pengesat dhe rreziku për funksionimin e shtetit të së drejtës janë, korrupsioni, krimi i organizuar, politizimi dhe partizimi i institucioneve, jo-profesionaliteti etj., sfida të cilat duhet të luftohen nga e gjithë struktura shoqërore, duke përfshirë jo vetëm organet dhe institucionet shtetërore por edhe ato jo shtetërore.

RËNDËSIA SHOQËRORE E SHTETIT JURIDIK

Kuptimi dhe rëndësia shoqërore e shtetit juridik, për nga aspekti teorik-shkencor, dalin si domosdoshmëri që lind nga aktualiteti i saj në jetën politike shoqërore në të gjitha shtetet demokratike sidomos si çështje shumë e rëndësishme për vendet postkomuniste që ndodhen në tranzicion. Në literaturën shkencore hasen jo pak mendime dhe definicione mbi shtetin juridik. Paraprakisht, do të shpjegojmë esencën e genies njerëzore në kuadër të shoqërisë së civilizuar dhe të organizuar mirë, të cilën e përbën liria personale, siguria personale, barazia me të tjerët para ligjit, mbrojtja nga diskriminimi si dhe shumë komponentë të tjerë të jetës shoqërore të civilizuar.

Kuptimi i shtetit juridik demokratik në kontekstin e saj bashkëkohor paraqet një kategori juridike dhe sociologjike, e cila jep kornizën optimale për lirinë e njeriut, barazinë e tyre në shanset për sukses, barazinë para organeve shtetërore dhe ligjit, por edhe kufizimin e shtetit dhe personave me funksione publike në shoqëri në parandalimin dhe pamundësimin e keqpërdorimit nga ana e tyre. Në të vërtetë, shteti i së drejtës, patjetër duhet të niset dhe të mbështetet në parimet themelore humane me vlera gjithë shoqërore siç janë: e drejta, drejtësia, morali, të drejtat natyrore të njeriut dhe në parimet e demokracisë.

Si koncept teorik dhe model shoqëror, për realizimin e të drejtës optimale të njeriut, shteti juridik demokratik para së gjithash paraqet një shtet demokratik qytetar dhe shtet i cili mundëson zhvillimin e drejtë dhe me dinjitet të njeriut, që do të thotë, realizimin e lirisë dhe të drejtave natyrore, që ndërthuren në vete edhe të drejtën e çdonjërit për kundërvënien ndaj organit shtetëror nëse pretendohet se ndaj tij janë shkelur të drejtat e garantuara.

Shtet juridik është ai shtet në të cilin askush nuk është mbi ligjin që domethënë, as edhe vetë ata që sjellin ligjin.

Nga përvoja e deritanishme e zhvillimit të shteteve demokratike, mund të nxjerrim elementet kryesore të cilat shërbejnë si komponentë në funksion të ndërtimit të shteteve përkatëse në shtete juridike dhe demokratike, nga të cilat do të veçojmë: instalimin e kontrollit efikas demokratik ndaj qeverisjes, garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ndarja e pushteteve, pavarësia e gjykatave, kufizimin e qeverisjes politike me drejtësinë, pluralizmi politik, konkurrenca e lirë ekonomike, liria e mediave, shprehja e lirë e fjalës etj.

Por, shtrohet pyetja, çka e kushtëzoi lindjen e idesë për institucionin shtet juridik?

Në një periudhë të gjatë të zhvillimit shoqëror politik gjatë historisë, kanë mbisunduar diktaturat dhe format e tjera të sundimit despotik, karakteristikë kryesore e të cilave ishte sundimi apo mbajtja e pushtetit nga një person ose një grup i vogël i oligarkëve të cilët në duart e tyre kishin bashkuar të gjitha pushtetet (legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor). Në këto periudha të sundimit, nuk ishin të garantuara të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe as që kishte një kornizë të drejtë që kufizonte ushtrimin e pushtetit nga bartësit e tyre. Nuk ekzistonte as edhe një shenjë nga elementet e pluralizmit politik si parakusht për ekzistimin e pushtetit demokratik.

Ekzistimi i monarkive absolute për një periudhë të gjatë, regjimeve despotike dhe totalitare në periudha të ndryshme kohore ishin disa forma të sundimit që aspak nuk njihnin nocionin e të drejtave të njeriut. Pikërisht kjo situatë me regjime totalitare dhe pushtet absolut krijoi terren të përshtatshëm për lindjen e ideve të para mbi afirmimin dhe realizimin e të drejtave të njeriut. Këto ide mandej janë avancuar në drejtim të formimit dhe konsolidimit të institucioneve, që rezultojnë me lindjen e shoqërive dhe shteteve të para demokratike dhe juridike.

Shtetet e reja demokratike, duke u mbështetur në parimet bazë për respektimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, krijuan hapësirë optimale dhe të mjaftueshme për fillimin e një epoke të re të zhvillimit në të gjitha fushat. (Daci, J. 2008:37) Zhvillimi i shkencave natyrore, mundësoi zhvillimin teknologjik industrial, zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e standardit jetësor, gjë që drejtë për së drejti ndikoi në ndërtimin e shoqërive më humane, më qytetare dhe më demokratike. Kjo më së miri mund të vërehet edhe sot nëse bëjmë krahasimin e shteteve demokratike me një traditë të gjatë, kundrejt shteteve që ndodhen në tranzicion dhe shteteve me regjim totalitar.

Gjithashtu, ajo që duhet të potencohet është fakti se teorisë së shtetit juridik i kanë paraprirë faza të rëndësishme që nënvizojnë sjelljen apo miratimin e rezolutave dhe deklaratave për të drejtat dhe liritë e njeriut, me anë të cilave u përcaktuan parimet themelore për organizimin dhe funksionimin e shteteve demokratike.

Trajtimi i konceptit të shtetit juridik në kontekstin politik nënkupton këtë institucion si krijesë shoqërore politike optimale për realizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, e cila mbështetet në ndarjen e pushteteve të cilën e garanton vullneti i shumicës mbi principin e legjitimitetit. Pikërisht kjo qasje nga konteksti politik, në plan të parë nxjerr vetitë dhe karakteristikat esenciale të shtetit juridik siç janë; sundimi i të drejtës dhe nënshtrimi i të gjithëve para ligjit, sjellje në përputhje me normat ligjore të miratuara etj.

Mendimi (opinion) publik dhe informimi i lirë dhe i drejtë janë mekanizmat demokratik kontrollues të parapara me ligj, për realizimin e parimeve themelore të shtetit juridik. Rëndësia e funksionimit të shtetit juridik, gjithashtu vlerësohet edhe në drejtim të zhvillimit ekonomik të shoqërisë që paraqitet edhe si një nga kushtet e saja për arsye të rregullimit të marrëdhënieve shoqërore ekonomike në kornizat ligjore në frymën e parimit të ekonomisë së lirë. Përveç rolit në sigurimin e të drejtave të njeriut, funksionimi i shtetit juridik luan rol të rëndësishëm (edhe pse nuk vërehet sa duhet dhe nuk merret në konsideratë) në garantimin e rregullave të lojës me anë të cilave mundësohet korniza e veprimit dhe praktikimit të aktiviteteve shoqërore, politike dhe ekonomike. Në kuptimin integral të shtetit juridik, e drejta si nocion ka tre kuptime themelore; kuptimin moral, politik dhe atë ekonomik. (Radonjiq, D. 2004:12)

Me qëllim të trajtimit dhe shqyrtimit sa më të saktë dhe të plotë të kuptimit dhe rëndësisë së shtetit juridik, duhet të merren parasysh dhe të analizohen të gjitha segmentet dhe elementet që përbëjnë faktorët e vlerësimit në përcaktimin e konceptit të shtetit demokratik dhe juridik.

Në këtë drejtim, me rëndësi është qëndrimi për shtetin juridik sipas të cilit ligji apo shteti i së drejtës duhet të jetë shprehje e vetëdijes kolektive në bashkësinë shoqërore e bazuar në vlerën e të drejtës dhe në vlerat morale universale mbi logjikën e të drejtave natyrore.

Një shtet demokratik duhet të funksionojë në frymën e shtetit juridik edhe në raste kur “gjithçka me ligj nuk është e ndaluar, individit i lejohet për ta bërë, ndërsa gjithçka që me ligj nuk është paraparë shtetit i ndalohet të shfrytëzojë”.

SHTETI JURIDIK DHE DEMOKRATIZIMI, VLERA DHE NORMA SHOQËRORE NË FUNKSION TË PROCESEVE TË LIDHURA ME GLOBALIZIMIN DHE INTEGRIMIN

Shteti juridik nëpërmjet institucioneve të saja dhe procedurave të parapara me ligj duhet të sigurojë kufizimin dhe kontrollin ligjor të shtetit dhe organeve të saja dhe të garantojë pacenueshmërinë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Ideja e funksionimit të shtetit juridik është ngushtë e lidhur me idetë tjera të përgjithshme e para së gjithash me;

- demokracinë, si kornizë politike për vendosjen e shtetit juridik
- shoqërinë civile, si aktor i përgjegjshëm dhe aktiv në formësimin e të mirës së përgjithshme dhe si kontrollues i institucioneve.

- parlamentarizmin, si kusht politik për vendosjen e të drejtës legjitime

- aplikimin e modelit që mundëson kontrollin mes pushteteve dhe gjyqësi të pavarur.

Shteti juridik nënkupton gjithashtu cilësinë e të drejtës si dhe zbatimin e saj adekuat, procedurat demokratike që institucionalizojnë jetën shoqërore dhe që pengojnë keqpërdorimet si dhe nevojën e konsensusit për mënyrën e organizimit të jetës shoqërore politike.

Respektimi i plotë i të gjitha elementeve përbërës dhe ideve përcjellëse të shtetit juridik është garanci më e mirë për zhvillim të drejtë dhe demokratizim të shoqërisë, si nevojë imanente e shteteve në tranzicion të zgjatur, veçanërisht duke pasur parasysh ndikimet e shumëfishta të proceseve globalizuese gjatë rrugës së integrimit.

Numërimi i attributeve dhe elementeve të shtetit juridik nuk duhet të nënkuptojë së me atë marrin fund vlerat e etabluara në një shtet demokratik, përkundrazi duke u zhvilluar nga ideja burimore deri në kuptimin integral, koncepti për shtetin juridik mban një minimum hapësirë dhe mundësi për zhvillim të mëtutjeshëm duke qenë e gatshme për të pranuar përmbajtje dhe vlera të reja.

Konsolidimi i shtetit juridik dhe demokratizimi i shoqërisë janë procese të ndërvarura mes veti dhe pothuajse të pandashme në rrugëtimin e ndërtimit të tyre. Që të dyja këto procese, megjithëse janë komplekse dhe të ndërlikuara për shkak të ndikimit të faktorëve të shumtë për ndërtimin e tyre, ato njëkohësisht paraqesin vlera të mëdha shoqërore me të cilat mundësohet apo synohet përmirësimi i jetës së qytetarëve.

Ndërtimi i shtetit ligjor dhe demokratizimi i tij është proces i gjatë dhe i vështirë por jo edhe i pamundur, sidomos për ato shoqëri të cilat me vullnetin e tyre kanë përqafuar demokracinë si sistem, apo ato shoqëri të cilat kanë lejuar që rrënjët e demokracisë të shtrihen në tërë strukturën e shtetit dhe që ndihmojnë proceset drejt rrugës së progresit dhe modernizimit.

Ndërtimi i shtetit ligjor gjithmonë ka qenë një sfidë për shoqëritë që përqafuan sistemin demokratik me të gjitha atributet e saja, dhe ky proces i ndërtimit, paraprakisht kërkon mes tjerash ekzistimin e frymës demokratike për t'u dhënë jetë të gjitha institucioneve të saja duke i bërë ato më funksionale me qëllim të përballimit të gjitha sfidave në rrugën e forcimit dhe ndërtimit të gjitha pjesëve të trupit politik shtetëror në rrugën e integritit. (Ibraimi, A. 2009: 57).

Funksionimi i parimit të sundimit të ligjit është njëri nga elementet qendrore dhe shumë i rëndësishëm për zhvillimin e gjithmbarshëm, që luan rolin themelor për konsolidimin e institucioneve si kusht për sigurinë qytetare.

Ndonëse ekziston një përkushtim verbal nga autoritetet e vendeve të rajonit për forcimin e shtetit ligjor dhe demokratizim më të madh shoqëror, dhe ndonëse janë ndërmarë disa hapa dhe aktivitete në këtë drejtim, problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen këto vende janë të shumta dhe të ndryshme, për çka akoma ka shumë për të bërë. Që të arrihen standardet e nevojshme evropiane, nga autoritetet e vendeve kërkohet vullnet dhe angazhim serioz në drejtim të plotësimit të kritereve themelore për instalimin e vlerave që prodhohen në sistemet demokratike.

Në rrethanat aktuale, duke parë rrjedhën e proceseve shoqërore politike, retorika e ndërtimit të shtetit ligjor është bërë aq dyshuese, sa mendojmë se mund të jetë vetëm një utopi e porealizueshme. Aq shumë flitet për të, sa nëse gjithë këto deklarata do të përktheheshin në punë, ndërtimi i shteti ligjor do të arrinte nivelet dhe standardet evropiane.

Sistemet juridike kushtetuese të vendeve të rajonit, veçanërisht të atyre postkomuniste, përshkruhen si sisteme komplekse dhe në disa raste konfuze, të cilat në një mënyrë paraqesin problem që obstruojnë (pengojnë) qartësinë dhe sigurinë juridike të qytetarit. Procesi i ndërtimit të një sistemi cilësor kërkon më shumë seriozitet, përkushtim dhe përqendrim në procedurat të cilat duhet të jenë transparente me pjesëmarrje të gjerë demokratike, gjatë zhvillimit dhe miratimit përfundimtar.

Siguria dhe qartësia juridike është e domosdoshme në krijimin dhe ndërtimin e sistemit juridiko kushtetues dhe është garanci për funksionimin e shtetit ligjor, veçanërisht në fushat e ndjeshme si respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, barazia e të gjithë qytetarëve para ligjit, liria e shprehjes, lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar etj.

Një segment i rëndësishëm dhe esencial në ndërtimin e shtetit ligjor, është respektimi i parimeve themelore apo krijimi i shtyllave bazë mbi të cilën zhvillohet jeta shoqërore politike në një vend. Në këtë aspekt, një shtyllë e fuqishme që ndihmon në konsolidimin e shtetit ligjor është parimi i funksionimit të pushtetit gjyqësor në mënyrë të pavarur dhe profesionale. Vetëm një sistem i kontrollit dhe balancimit të pushteteve përmes ndarjes dhe zbatimit të kompetencave dhe ushtrimit e detyrave në kufijtë e ingerencave të caktuara nga ligji krijojnë mekanizmin për parandalimin e keqpërdorimeve nga autoritetet politike publike që gjithashtu përbën një nga shtyllat kryesore për ndërtimin e “Kalasë” të quajtur shteti i së drejtës. Çdo mosrespektim i parimeve bazë në drejtim të konsolidimit të shtetit juridik pason me çrregullime shoqërore të cilat paraqesin vështirësi reale në funksionimin normal të gjitha institucioneve dhe përbërësve tjerë shoqërorë. (Vasiq, R. 2004: 75)

Natyrisht që ndërtimi i tij, nuk mund të jetë vetëm kontribut i institucioneve shtetërore ndaj të cilave janë pritshmëritë më të mëdha, por para së gjithash duhet të jetë produkt i gjithë angazhimit qytetar, i gjithë shoqërisë civile. Për mungesën e tij të gjithë janë bashkëfajtorë, madje edhe kur heshtet, sepse heshtja i hap rrugën asaj fare që është mbjellë dhe po bën politika në kundërshtim me interesat dhe objektivat e shoqërisë.

FAKTORËT QË PENGOJNË FUNKSIONIMIN E SHTETIT LIGJOR

Natyrisht, liria pa kufi nuk është i vetmi faktor që pengon një shtet të demokratizohet. Këto faktorë janë të shumtë. Pak a shumë këto faktorë janë të shpjeguara si më sipër kur është bërë analiza e raportit të shtetit me ligjin dhe demokracinë, të shtetit me shoqërinë dhe demokracinë, dhe të shtetit me autoritetet udhëheqëse në aspektin moral në demokraci. Sipas gjithë kësaj, faktorët që pengojnë zhvillimin e demokracisë dhe demokratizimit të shoqërisë në një shtet janë:

- rritja e korrupsionit
- informaliteti

- qëndrimi i drejtuesve për një kohë të gjatë në krye të pushtetit
- ndikimi i interesave vetjake në ushtrimin e funksionet shtetërore
- një qeverisje e paqëndrueshme
- shpërdorimi i ligjeve nga qeveria
- shpërdorimi i ligjeve nga shoqëria

Në rast se këto fakte nuk do të ishin të pranishëm në një shtet, atëherë mund të flisnim për një proces të rregullt të demokratizimit. Edhe në rastin kur në një shoqëri apo shtet ekziston edhe vetëm njëra nga këto dukuri të sipërpërmendura, demokratizimi has në vështirësi. Kjo ndodh ngase të gjitha këto kritere kanë lidhje të ngushtë me njëra-tjetrën.

CONCLUSION

Democracy and rule of law are the basic elements that make up an indivisible unit for a functional state. A functional rule of law state means the rule of law and order, the respect for human rights, as well as all the basic principles and methods of procedure, which guarantee the individual and collective freedom, which allows the participation of individuals in the political, economic, social, and cultural life.

In a state with the rule of law, all citizens should be equal, and secure in front of the order and law, there shouldn't be a discrimination of citizens because of ethnic, religious, racial, political, cultural, and gender affiliation. Each citizen living within the legal state should be able to protect and enjoy his rights against government officials, and arbitrary decisions, even if the political bodies are trying to take away these rights. This is particularly essential for the right to free disclosure of personality, for the preservation and security of this right is the main meaning of the constitutional state. In this way, the rule of law state is also a constitutional state law.

The legal state authority should provide space to freedom to citizens and citizenry, because this authority should intervene only when it is authorized to establish law and order, as well as public safety. Such a right can only be adopted by the chosen of the people, who earn the right to govern with the people in a legal proceeding and formal elections in accordance with the constitution, laws and international conventions. The individual and the citizens in the rule of law state should be allowed to influence in their own way and unconstrained, in the regulation of civic and political life, in order to put forwards the state order governed by the constitution and laws.

The Legal civic security can exist only when citizens are fully aware of what the state must do for the citizens and the rights that are regulated by the state, and what are the civil rights and responsibilities before the state. Here takes part the fundamental principle of the state for respect to all citizens, according to which no one may be punished without legal basis, where all citizens should enjoy equal rights without discrimination, and to be respected in front of the law.

The rule of law state must be careful and pay attention on the discrimination against certain citizens because of racial, religious affiliation and political beliefs, and citizens should enjoy respect within the legal state, which civic equality is regulated by the Constitution, the basic laws and the international Conventions.

LITERATURA

Daci, J. (2008), Të drejtat e njeriut, "Julvin", Tiranë

Ibraimi, A. (2009), Integrimi i Ballkanit Perëndimor në UE, "Logos A", Shkup

Lon L. Fuller, (1969), The Morality of Law (revised edition), Yale University Press.

Radonjiq, D. (2004), Demokratija "3M" Podgorica

R. Vasiq, (2004) Pravna država i tranzicija. Teorijski model i kontekstualno uslovljavanje, Beograd.